

Mohim i përgjegjësive

Plani i Veprimit mbi Përmirësimin e Situatës së Romëve dhe Sintive brenda zonës së OSBE-së u dakordua nga shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së në Këshillin e Ministrave më 1 dhe 2 dhjetor 2003, në Mاستriht, Holandë. Versioni shqip është një përkthim jozyrtar, përgatitur me mbështetjen e Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe Drejtat të Njeriut (ODIHR), Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Misioni i OSBE-së në Shkup. Aty ku ekzistojnë dallimet në mes të këtij përkthimi dhe tekstit origjinal, ju lutemi referojuni Vendimit në një nga gjashtë gjuhët zyrtare të OSBE-së si version përfundimtarë dhe zyrtarë, e që mund të shkarkohet këtu: <http://www.osce.org/odihr/17554>

1 dhe 2 dhjetor 2003, Mاستriht, Holandë

VENDIMI Nr 3/03

**PLANI I VEPRIMIT MBI PËRMIRËSIMIN E GJENDJES SË
ROMËVEDHE SINTIVE BRENDA RAJONIT TË OSBE-së
(MC.DEC/3/03)**

Këshilli i Ministrave,

Përkushtuar për të respektuar drejtat e njeriut dhe liritë themelore për të gjithë, pa dallim race, ngjyre, gjinie, gjuhe, feje apo besimi, opinionin politik ose tjetër, origjinin sociale apo kombëtarë, tipari, lindjes apo statusi tjetër,

Mbështet miratimin dhe zbatimin e legjislacionit gjithëpërfshirës kundër diskriminimit për të promovuar barazi të plotë dhe mundësi për të gjithë,

Duke njohur ekzistimin e vështirësive të veçanta me të cilat përballet popullsia rome dhe sinti dhe nevojën për të ndërmarrë masa efektive për të çrrënjësuar diskriminimin ndaj tyre dhe për të realizuar mundësi të barabarta, në përputhje me angazhimet e OSBE-së,

Duke njohur përparimin e arritur në legjislacionin shtetëror dhe në programe të veprimit dhe se në këtë drejtim janë bërë përpjekje të konsiderueshme nga shtetet pjesëmarrëse,

Të vetëdijshëm në të njëjtën kohë se veprimi i vendosur është ende i nevojshëm për përmirësimin e gjendjes së popullsisë rome dhe sinti në të gjithë rajonin e OSBE-së,

Duke vënë në dukje diversitetin e pasur kulturor, gjuhësor dhe historik të romëve dhe sintive në zonën e OSBE-së, si dhe diversitetin e strukturave shtetërore dhe traditave në zonën e OSBE-së,

Duke vënë në dukje rezultatet e konferencave të rëndësishme qeveritare dhe jo-qeveritare dhe të iniciativave për romët dhe sintit në Evropë të kohës së fundit, përfshirë këtu, ndër të tjera, nismën e një Dekade të Përfshirjes së Romëve dhe krijimin e mundshëm të një Forumi Evropian për Romët dhe Shtegëtarët,

Të bindur se popullsia rome dhe sinti duhet të ketë një shkallë gjithnjë në rritje të zotërimit të politikave të përqëndruar mbi ta,

Vendos të miratojë Planin e Veprimit mbi Përmirësimin e Situatës së Romëve dhe Sintive brenda zonës së OSBE-së, të miratuar nga Këshilli i përhershëm me vendimin e saj nr 566 më 27 nëntor 2003, dhe bashkëlidhur këtij vendimi.

Shtojca Vendimit Nr 3/03

**PLANI I VEPRIMIT MBI PËRMIRËSIMIN E GJENDJES SË ROMËVEDHE
SINTIVE BRENDA RAJONIT TË OSBE-së**



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim ne Evropë
Këshilli i Përhershëm

PC.DEC/566
27 Nëntor 2003

Origjinali: ANGLISHT
Kopja: SHQIP

479ta Mbledhje Plenare

PC Zhurnali No. 479, Rendi I ditës 4

VENDIMI No. 566
PLANI I VEPRIMIT MBI PËRMIRËSIMIN E GJENDJES SË ROMËVE
DHE SINTIVE BRENDRA RAJONIT TË OSBE-së

Këshilli i Përhershëm,

Vendosë të adoptojë Planin e Veprimit mbi Përmirësimin e Gjendjes së Romëve dhe Sintive mbrendra rajonit të OSBE-së, të aneksuar këtij vendimi.

PLANI I VEPRIMIT MBI PËRMIRËSIMIN E GJENDJES SË ROMËVE DHE SINTIVE BRENDA RAJONIT TË OSBE-së

I. Fushëveprimi dhe objektivat

1. Plani i veprimit ka për qëllim t'i përforcojë përpjekjet e shteteve pjesëmarrëse dhe institucioneve dhe strukturave relevante të OSBE-së me qëllim që të sigurojë se populli rom dhe sinti është në gjendje të luajë rol të plotë dhe të barabartë në shoqëritë tona, si dhe të çrrënjos diskriminimin kundër tyre.
2. Plani i veprimit mbështetet në kornizën e ligjeve ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut, zotimet ekzistuese të OSBE-së dhe shembujt e praktikave më të mira nga vendet e Evropës, ku ato ekzistojnë, si dhe në qëllimet për mbështetjen e praktikave të tilla gjetiu. Masat e veçanta të parashikuara me Planin e veprimit, që synojnë përmirësimin e gjendjes së popullit rom dhe sinti, mbështeten në Konventën Ndërkombëtare për zhdukjen e të gjitha formave të diskriminimit racia¹.
3. Si shtetet pjesëmarrëse ashtu edhe strukturat e OSBE-së ftohen që të zbatojnë Planin e veprimit. Komunitetet rome dhe sinti në shtetet pjesëmarrëse ftohen të mbështesin dhe kontribuojnë në mënyrë aktive për vënien në jetë të dispozitave të Planit të veprimit.

II. Konteksti i përgjithshëm: për romët, me romët

4. Çdo politikë kombëtare ose strategji e zbatimit duhet: (1) t'u përgjigjet problemeve, nevojave dhe prioriteteve reale të komuniteteve rome dhe sinti; (2) të jetë gjithëpërfshirëse; (3) të përfshijë një qasje të ekuilibruar dhe të qëndrueshme të kombinimit të qëllimeve të të drejtave të njeriut me politikat sociale; dhe (4) të maksimalizojë pronësinë e romëve në politikat që ndikojnë në ta. Njëherit, politikat kombëtare ose strategjitë e vënies së tyre në jetë duhet të përshtaten dhe të zbatohen sipas nevojave të veçanta të popullatave të romëve dhe të sintive në situatat e veçanta të shteteve pjesëmarrëse. Strategjitë e zbatimit duhet po ashtu të përfshijnë mekanizma për të siguruar që politikat kombëtare të vihen në jetë në nivelin lokal.
5. Parimi udhëzues në përpjekjet e shteteve pjesëmarrëse dhe institucioneve relevante të OSBE-së duhet të jetë që secila politikë dhe strategji e zbatimit të përpunohet dhe zbatohet

¹ Neni I, alinea 4 shkruan: "Masat e veçanta, të ndërmarra për të vetmin qëllim të sigurimit të përparimit adekuat të disa grupeve ose individëve racorë dhe etnikë që kërkojnë mbrojtjen e tillë që mund të jetë e nevojshme për t'u siguruar grupeve ose individëve të tillë për të gëzuar ose ushtruar të drejta të barabarta të njeriut dhe të lirive themelore, nuk do të konsiderohen diskriminim racia, po qe se, megjithatë, masat e tilla nuk shpiejnë, si pasojë e kësaj, në ruajtjen e të drejtave të veçanta të grupeve të ndryshme racore, dhe se ato nuk do të vazhdohen pasi të jenë arritur objektivat për të cilët janë marrë ato."

me pjesëmarrjen aktive të komuniteteve rome dhe sinti. Është qenësore që të sigurohet pjesëmarrje reale e popullatës rome dhe sinti në të gjitha vendimet që ndikojnë në jetën e tyre. Popullata rom dhe sinti duhet të punojë krahas autoriteteve lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare në zhvillimin e këtyre strategjive. Po ashtu, komunitetet rome duhet të jenë partnerë të barabartë dhe t'i ndajnë përgjegjësitë për përmirësimin e mirëqenies së tyre.

6. Gjendja e posaçme e grave rome dhe sinti duhet të merret parasysh me rastin e përpilimit dhe të zbatimit të të gjitha politikave dhe programeve. Kur ekzistojnë mekanizma konsultativë dhe të tjerë për lehtësimin e pjesëmarrjes së popullatës rome dhe sinti në proceset e tilla të krijimit të politikave, gratë duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në baza të barabarta me burrat. Çështjet e grave të romëve duhet të gjejnë vend në mënyrë sistematike në të gjitha politikat relevante të përpiluara për këtë popullatë në përgjithësi.

III. Luftimi i racizmit dhe diskriminimit

Për t'i luftuar paragjykimet ndaj romëve dhe sintive dhe për të hartuar dhe zbatuar efektshëm politika për luftimin e diskriminimit dhe dhunës racore, rekomandohen veprimet vijuese:

Legjislacioni dhe zbatimi i ligjit

Veprimet e rekomanduara nga shtetet pjesëmarrëse:

7. Të shqyrtohet ratifikimi i traktateve ndërkombëtare relevante sa më shpejtë, nëse tashmë nuk është vepruar ashtu, mes tjerash, *Konventën Ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor*.

8. Të miratohet dhe zbatohet legjislacionin kundër diskriminimit për të luftuar diskriminimin racor dhe etnik në të gjitha fushat, duke përfshirë, mes tjerash, qasjen në banim, nënshtetësi dhe vendbanim, arsimim, punësim, shëndetësi dhe shërbime sociale. Të përfshihen përfaqësuesit e romëve dhe sintive në procesin e përpilimit, zbatimit dhe vlerësimit.

9. Legjislacioni kundër diskriminimit duhet të sigurojë:

- Ndalimin e diskriminimit racor të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë;
- Vendosjen e sanksioneve efektive, përkatëse dhe zbindëse për aktet ose praktikatat diskriminuese;
- Caktimin e ndëshkimeve më të rënda për krimet me motivacion racor të kryera nga individët privatë dhe zyrtarët publikë;
- Qasjen e barabartë në mjete juridike efektive (procedura gjyqësore, administrative, të pajtimit dhe të ndërmjetësimit).

10. Duhet të siguroheni që legjislacioni kombëtar ndalon të gjitha format e veprimeve të diskriminimit dhe që të gjitha rastet e diskriminimit të dyshuar të hetohen plotësisht dhe në mënyrë objektive.

11. Të krijohen, kur është e përshtatshme, institucione të specializuara për të siguruar vënien në jetë të legjislacionit të tillë, si dhe mekanizma vendorë për të mbikëqyrur dhe raportuar rregullisht dhe me transparencë për përparimin e arritur në zbatimin e tyre. Të inkurajohet pjesëmarrja e përfaqësuesve të romëve dhe të sintive në organet e tilla, puna e të cilëve do të jetë e hapur për publikun.

12. Të zhvillohen, sipas nevojës, strategji kombëtare gjithëpërfshirëse ose plane të veprimit për të përmirësuar gjendjen e popullit rom dhe sinti, duke përfshirë masa të veçanta për trajtimin e diskriminimit në të gjitha fushat e jetës.

13. Të vlerësohen rregullisht, sidomos në nivelin lokal, rezultatet e këtyre strategjive dhe të përfshihen komunitetet rome dhe sinti në procesin e vlerësimit.

14. Të bëhen përpjekje, duke inkurajuar një dialog ose konsultime të mirëfillta ose përmes mjeteve të ndryshme të përshtatshme, për të përmirësuar marrëdhëniet midis popullit rom dhe sinti dhe banorëve të tjerë, me synim të avancimit të tolerancës dhe tejkalimit të paragjyqimeve dhe stereotipeve negative nga të dyja anët.

15. Të dokumentohen, në konsekuencë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave, të gjitha llojet dhe rastet relevante të diskriminimit për të vlerësuar më mirë gjendjen dhe për t'iu përgjigjur nevojave të popullit rom dhe sinti.

16. Të sigurohen hetime të thukëta dhe efektive të akteve të dhunës kundër popullit rom dhe sinti, sidomos kur ka baza të dyshimit se janë ato janë bërë me motiv racor, dhe të ndiqen penalisht përgjegjësit sipas ligjit të vendit dhe në përputhje me standardet relevante të të drejtave të njeriut.

17. Të sigurohet se nuk ka pandëshkueshmëri për kryerësit e akteve të diskriminimit apo dhunës, në mes tjerash, duke ndërmarrë veprime të shpejta dhe efektive të hetimeve dhe të dënimeve nga ana e policisë.

18. Të lehtësohet qasja e popullit rom dhe sinti në drejtësi përmes masave të tilla siç janë ndihma juridike dhe ofrimi i informatave në gjuhën rome.

19. Të merren parasysh të gjitha masat dhe programet, gjendja e grave rome dhe sinti, të cilat janë shpesh viktima të diskriminimit në baza të përkatësisë etnike dhe seksit.

Veprimet e rekomanduara nga institucionet dhe strukturat e OSBE-së:

20. ODIHR-i dhe, kur është e përshtatshme, institucionet dhe strukturat e tjera të OSBE-së, duke përfshirë operacionet në terren të OSBE-së, do t'iu ndihmojnë shteteve pjesëmarrëse, me kërkesën e tyre, për të zhvilluar legjislacion kundër diskriminimit, si dhe për të themeluar organe kundër diskriminimit.

21. KLPK-ja, brenda mandatit të vet, do të vazhdojë të ndjekë hartimin e legjislacionit kundër diskriminimit dhe të sigurojë këshilla dhe ndihmë për shtetet pjesëmarrëse në këtë aspekt, nëse është e përshtatshme.

22. Në bazë të një kërkesë, ODIHR-i do të sigurojë këshillë se si një mekanizëm ekzistues i shteteve pjesëmarrëse, siç janë zyrat e avokatit të popullit, komisionet për luftimin e diskriminimit, komisionet disiplinore të policisë, dhe organet e tjera relevante mund t'i zbusin tensionet midis romëve dhe sintive si dhe komuniteteve jo-rome.

23. ODIHR-i/Pika e kontaktit për çështjet e romëve dhe të sintive (PKÇRS) do të nxisin marrëdhënie më të mira midis organizatave joqeveritare (OJQ) të romëve dhe të sintive dhe shteteve pjesëmarrësve.

24. ODIHR-i/PKÇRS-ja do të shërbejë si zyrë qendrore për nismat e ndërmarra nga shtetet pjesëmarrëse dhe do të lehtësojë këmbimet e informatave të praktikave më të mira.

25. ODIHR-i/PKÇRS-ja, në bashkëpunim të ngushtë me shtetet pjesëmarrëse, komunitetet rome dhe sinti, dhe kur ka mundësi me organizata të tjera ndërkombëtare, duke i respektuar plotësisht ligjet për mbrojtjen e të dhënave personale, do të mbledh dokumentacion për qëllim të zhvillimit të politikave më synim më të fokusuar.

Policia

Veprimet e rekomanduara nga shtetet pjesëmarrëse:

26. Të zhvillohen politika që shtojnë vetëdijen ndër institucionet e zbatimit të ligjit përkitazi me gjendjen e popullit rom dhe sinti dhe që kundërshtojnë paragjykimet dhe stereotipet negative.

27. Të përpilohen programe të trajnimit për të parandaluar përdorimin e forcës së tepruar dhe për të nxitur vetëdijen dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

28. Të zhvillohen politika: (1) për të përmirësuar marrëdhëniet midis komuniteteve të romëve dhe të sintive dhe policisë, në mënyrë që të parandalohet abuzimi dhe dhuna policore kundër popullit rom dhe sinti; dhe (2) për të shtuar besimin dhe mirëbesimin e popullit rom dhe sinti tek policia.

29. Të hartohen politika dhe procedura për të siguruar reagim efektiv të policisë ndaj dhunës së motivuar në baza racore kundër popullit rom dhe sinti.

30. Të vlerësohet zbrazëtira midis standardeve ndërkombëtare për policinë dhe praktikës aktuale kombëtare në konsultim me forcat e policisë kombëtare, OJQ-të dhe përfaqësuesit e komunitetit rom dhe sinti.

31. Të hartohen, kur është e përshtatshme, dhe në bashkëpunim të ngushtë me organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të e romëve, deklaratat të politikave, kode të mirësjelljes, doracakë praktikë udhërrëfimi dhe programe të trajnimit.

32. Të inkurajohet populli rom dhe sinti që të punojë në institucionet e zbatimit të ligjit si mjet i qëndrueshëm për nxitjen e tolerancës dhe diversitetit.

Veprimet e rekomanduara nga institucionet dhe strukturat e OSBE-së:

33. Njësia për Çështje Strategjike të Policisë në Sekretariatit e ODIHR-it do t'u ndihmojë shteteve pjesëmarrëse në zhvillimin e programeve dhe masave për krijimin e besimit — siç është policimi në komunitet — për të përmirësuar marrëdhëniet midis popullit rom dhe sinti dhe policisë, sidomos në nivelin lokal.

34. ODIHR-i/PKÇRS-ja dhe Njësia për Çështje Strategjike të Policisë, brenda mandateve të tyre përkatëse, do të hartojnë një përmbledhje të “praktikave të mira” të policisë në rajonin e OSBE-së përkitazi me veprimtarinë policore dhe komuniteteve rome dhe sinti.

35. KLPK-ja, ODIHR-i/PKÇRS-ja dhe Njësia e Çështjeve Strategjike të Policisë do t'u ndihmojnë shteteve pjesëmarrëse për të përpiluar kode të sjelljes për parandalimin e profilizimit racor dhe për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike.

Masmediet

Veprimet e rekomanduara nga shtetet pjesëmarrëse:

36. Të zhvillohen fushata informuese dhe ndërgjegjësimi me synim të kundërshtimit të paragjyqimeve dhe stereotipeve për popullin rom dhe sinti.

37. Të mbështetet liria e shprehjes, të inkurajohet trajnimi i gazetarëve romë dhe sinti dhe punësimi i tyre në masmedia me qëllim të lehtësimit të qasjes më të gjerë në mediet për popullatën rome dhe sinti.

38. Të inkurajohen mediet që t'i tregojnë aspektet pozitive dhe të paraqesin një portret të balancuar të jetës së romëve, të përmbahen nga stereotipimi i popullit rom dhe sinti dhe t'i shmangen nxitjes të tensioneve midis grupeve etnike të ndryshme. Të organizohen tryeza të rrumbullakëta midis përfaqësuesve të medieve dhe përfaqësuesve të romëve dhe sintive për të promovuar këta objektiva.

Veprimet e rekomanduara nga institucionet dhe strukturat e OSBE-së:

39. Në bashkëpunim me ODIHR-in si dhe me organizatat ndërkombëtare relevante, Përfaqësuesi për lirinë e medieve (PLM) duhet të shqyrtojë se si mund të kontribuojë OSBE-ja në themelimin e një Radioje rome evropiane, e cila do të transmetohej nëpër Evropë. ODIHR-i dhe PLM-ja duhet të organizojnë debate publike, fushata kundër diskriminimit dhe programe të përbashkëta të trajnimit me median dhe për të.

40. PLM-ja duhet të marrë parasysh organizimin e seminareve të trajnimit për gazetarët romë.

41. ODIHR-i/PKÇRS-ja dhe PLM-ja do të organizojnë tryeza të rrumbullakëta me gazetarët për imazhin që kanë komunitetet rome dhe sinti në shoqëri.

42. KLPK-ja do të vazhdojë të hartojë dhe shpërndajë udhëzime për politikëbërësit për shfrytëzimin e mediave me transmetim shtetëror tek komunitetet shumëkulturore, me qëllim, mes tjerash, që të inkurajohet përkrahja e transmetuesve të pakicave, duke përfshirë transmetuesit romë dhe sinti dhe përmirësimin e qasjes së tyre në medie.

IV. Trajtimi i çështjeve socio-ekonomike

Kërkohej veprim për të siguruar që populli rom dhe sinti gëzon të drejtat sociale dhe ekonomike në nivel të barabartë me të tjerët. Në veçanti nevojiten masa në nivel të bazës, sidomos ato që dalin nga vetë grupet rome, për të promovuar integrimin e popullit rom dhe sinti në jetën sociale dhe ekonomike dhe për të luftuar izolimin dhe varfërinë e tyre. OSBE-ja dhe shtetet e saj pjesëmarrëse duhet të vazhdojnë të lehtësojnë integrimin e tillë.

Banimi dhe kushtet e jetës

Veprimet e rekomanduara nga shtetet pjesëmarrëse:

43. Të vendosen mekanizma dhe procedura institucionale për t'i sqaruar të drejtat e pronës, zgjidhur çështjet e pronësisë dhe rregulluar statusin e popullit rom dhe sinti që jeton në rrethana të legalitetit të pazgjidhur (p.sh., lagjet e romëve që nuk kanë të drejta të tokës ose të cilat nuk janë përfshirë në planin urbanistik të lokalitetit kryesor; familjet dhe shtëpitë pa banorë me status juridik në vendbanimet ku ata njerëz faktikisht kanë qenë duke jetuar me dekada).

44. Të përfshihet populli rom dhe sinti në përpilimin e politikave të banimit, si dhe në ndërtimin, rehabilitimin dhe/ose mirëmbajtjen e projekteve të banimit publik që ka qëllimin e përfitimit nga ato. Të sigurohet që projektet e banimit të mos mbështesin segregacionin etnik apo racor.

45. Të shqyrtohen mundësitë e garantimit të huave të shteteve pjesëmarrëse që mund të jenë në dispozicion nga organizatat ndërkombëtare dhe institucionet financiare për projekte për banim për personat me të ardhura të ulëta.

46. Të promovohet opsioni i skemave të banimit bashkëpunues për komunitetin rom dhe të sigurohet trajnimi përkatës për mirëmbajtjen e objekteve të tilla.

Veprimet e rekomanduara nga institucionet dhe strukturat e OSBE-së:

47. ODIHR-i/PKÇRS-ja dhe Zyra e Koordinatorit të Aktiviteteve Ekonomike dhe të Ambientit (ZKAEA) inkurajohen të luajnë rol më të madh për lehtësimin e sigurimit të informatave të resurseve dhe qasjes në to të mundësuar nga donatorët e jashtëm për projektet e veçanta, sidomos të atyre që krijohen nga grupet rome dhe sinti, duke e shqyrtuar zhvillimin social dhe ekonomik të komuniteteve rome dhe sinti.

Papunësia dhe problemet ekonomike

Veprimet e rekomanduara nga shtetet pjesëmarrëse:

48. Të avancohet përfaqësimi i shtuar i popullit rom dhe sinti në punësimin publik.

49. Të përpilohen programe të trajnimit për të përgatitur grupet me përfaqësim të ulët të romëve dhe sintive për punësim në administratën publike lokale dhe fusha të tjera, si dhe të zhvillohen politika për të inkurajuar punësimin e të diplomuarve të këtyre programeve si shërbyes civilë.

50. Të rivlerësohet ndikimi i programeve të subvencionuara të punësimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë komponenteve të tyre të arsimit, për të siguruar që kjo të nënkuptojë shtimin e konkurrencës së popullatës romë dhe sinti në tregun e punës.

51. Të zhvillohen politika dhe programe, duke përfshirë edhe trajnim profesional, për t'i përmirësuar shkathtësitë që i pranon tregu dhe aftësitë e punësimit të popullit rom dhe sinti, në veçanti të rinjve dhe grave.

52. Të miratohen politika sociale që forcojnë stimulimet për të kërkuar punë, si mënyrë e qëndrueshme për t'i ikur varësisë nga përfitimet sociale.

Veprimet e rekomanduara nga institucionet dhe strukturat e OSBE-së:

53. Me kërkesën e shteteve pjesëmarrëse, ZKAEA-ja, së bashku me organizatat relevante ndërkombëtare, do të kontribuojë në zhvillimin e qasjeve të krijuara për të tejkaluar pengesat dhe diskriminimin që parandalon popullin rom dhe sinti të mos e përmbushë potencialin e duhur në sferën ekonomike.

54. Me kërkesën e shteteve pjesëmarrëse, ODIHR-i/PKÇRS-ja dhe ZKAEA-ja do të përkrahin zhvillimin e punësimit dhe shkathtësive ndërmarrëse të popullit rom dhe sinti përmes krijimit të programeve të trajnimit dhe ritrajnimit në shtetet pjesëmarrëse. Praktikrat me sukses, sidomos ato që lidhen me zhvillimin e shkathtësive ndërmarrëse dhe të ndërmarrjeve të përmasave të vogla dhe të mesme (NVM) (p.sh., programi i seminareve të ndërmarrësve të rinj) do të mund të përshtatej për nevojat e popullit rom dhe sinti. Gjithashtu, ZKAEA-ja do të mund të lehtësonte ndërfutjen ekonomike dhe sociale duke vepruar si katalizator për përkrahjen nga organizatat partnere dhe institucionet financiare të programeve të mikrokredive, në formë të kredive të vogla për themelimin e biznesit të shkallës së ulët.

55. ZKAEA-ja, duke punuar në kontakt të ngushtë dhe në bashkëpunim me organizatat e tjera ndërkombëtare, në mënyrë që t'i shmangët duplikimit të veprimeve, mund t'i ndihmojë qeveritë në vlerësimin e ndikimit të politikave ekonomike dhe proceseve në komunitetet e romëve dhe sintive (duke zhvilluar treguesit e performancës së politikës/vlerësimit).

56. ODIHR-i/PKÇRS-ja dhe ZKAEA-ja do bazohen në hulumtimin e zhvilluar nga UNDP-ja dhe agjencitë e tjera për t'i vlerësuar nevojat e popullit rom dhe sinti me synim të mbështetjes së politikave që marrin parasysh përmasën dhe natyrën e nevojave të veçanta në çdo shtet pjesëmarrës.

57. Në bashkëpunim me organizatat relevante ndërkombëtare (posaçërisht me UNDP-në dhe Bankën Botërore), ODIHR-i/PKÇRS-ja dhe ZKAEA-ja do t'i shqyrtojnë mënyrat për stimulimin e qasjes më të mirë të popullatës romë dhe sinti në programet e trajnimit të rregullt. Mund të organizohen diskutime në seminare ose tryeza të rrumbullakëta të sistemuara për nevojat e popullatës romë dhe sinti, me qëllim të informimit dhe të edukimit të anëtarëve të komunitetit përkritazi me të drejtat ekonomike dhe sociale individuale dhe të ndërmarrësve.

Kujdesi shëndetësor

Veprimet e rekomanduara nga shtetet pjesëmarrëse:

58. Të sigurohet që popullata rome dhe sinti ka qasje në shërbimet e kujdesit shëndetësor në bazë jodiskriminuese.
59. Të ngrihet vetëdijesimi për nevojat e veçanta të popullatës rome dhe sinti në mesin e personelit të kujdesit shëndetësor.
60. Të trajtohet paraqitja e lartë e sëmundjeve dhe të ushqyerit e dobët tek komunitetet rome.
61. Të nxitet qasja nga popullata rome dhe sinti në shërbimet e shëndetit publik të përgjithshëm në fazën e hershme duke:
- (a) Informuar popullatën rome dhe sinti se ka shërbime të tilla dhe duke u treguar se si t'i shfrytëzojnë ato;
 - (b) Forcuar besimin e popullatës rome dhe sinti ndaj ofruesve publikë të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë përmes: dënimit të incidenteve të diskriminimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të përjetuar nga popullata rome dhe sinti; duke i trajnuar punëtorët e kujdesit shëndetësor për t'i kuptuar aspektet relevante të kulturës rome; si dhe duke përkrahur ndërmjetësit të cilët mund të luajnë rol të rëndësishëm duke krijuar ura midis komuniteteve rome dhe atyre që ofrojnë shërbime të kujdesit shëndetësor publik.
62. T'i kushtohet vëmendje e veçantë shëndetit të grave dhe vajzave, përveç tjerash, duke:
- (a) Avancuar dhe/ose zhvilluar programe me qëllim të sigurimit të informatave për kujdesin shëndetësor (duke përfshirë ushqimin, kujdesin për të porsalindurit dhe dhunën në shtëpi etj.);
 - (b) Përmirësuar qasjen në kujdesin shëndetësor gjinekologjik, përfshirë shërbimet për kujdesin shëndetësor për të porsalindurit, kujdes gjatë dhe pas lindjes, përveç tjerash, përmes sigurimit të informimit dhe trajnimit.
63. T'i kushtohet vëmendje e posaçme shëndetit të fëmijëve të romëve të sintive përmes ofrimit të kujdesit përkatës pediatrik, duke përfshirë edhe masat preventive siç janë ofrimi i vaksinimit në vendbanimet e romëve.

Veprimet e rekomanduara nga institucionet dhe strukturat e OSBE-së:

64. Në bashkëpunim me organizatat e tjera ndërkombëtare dhe OJQ-të, ODIHR-i do të ndihmojë që të dhënat e hulumtimeve ekzistuese t'i identifikojnë faktorët socio-ekonomikë, politikë dhe kulturorë që kanë ndikim në gjendjen shëndetësore sidomos të popullatës rome dhe sinti, dhe do të këshillojnë shtetet pjesëmarrëse përkitazi me programet e kujdesit shëndetësor, të cilat do t'u përgjigjeshin nevojave të identifikuara.

65. ODIHR-i/PKÇRS-ja dhe, kur është e përshtatshme, institucionet dhe strukturat e tjera të OSBE-së, duke përfshirë operacionet në terren, do t'u ndihmojnë shteteve pjesëmarrëse për nisjen e iniciativës arsimore për t'i ndihmuar popullatën romë dhe sinti që t'i shfrytëzojnë plotësisht shërbimet e rregullta shëndetësore. Ato, përveç tjerash, do të mbledhin, prodhojnë dhe përhapin informatën përkatëse për praktikatat e mira.

66. ODIHR-i/PKÇRS-ja do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë që të sigurojnë që populli rom dhe sinti kanë qasje në programet që kanë qëllimin e parandalimit dhe/ose të trajtimit të keqpërdorimit dhe varësisë së drogës dhe dhe AIDS dhe sëmundjet e ngjashme.

V. Përmirësimi i qasjes në arsim

Arsimi është parakusht për pjesëmarrjen e popullatës romë dhe sinti në jetën politike, sociale dhe ekonomike të vendit të tyre përkatës në hap të barabartë me të tjerët. Masave të fuqishme të menjëhershme në këtë fushë, sidomos atyre që mbështesin ndjekjen në shkollë dhe luftojnë kundër analfabetizmit, duhet t'u jepet prioriteti më i lartë si nga ata që marrin vendime ashtu edhe nga komunitetet e romëve dhe të sintive. Politikatat e arsimit duhet të synojnë të integrojnë popullatën romë dhe sinti në orientimin kryesor drejt arsimit duke u siguruar qasje të plotë dhe të barabartë, ndërsa të mbeten të ndjeshëm ndaj dallimeve kulturore.

Veprimet e rekomanduara nga shtetet pjesëmarrëse:

67. Të sigurohet që legjislacioni kombëtar përfshin dispozita adekuate për pengimin e segregacionit dhe diskriminimit në arsim dhe të sigurojë masa përmirësuese efektive kundër dhunimit të legjislacionit të tillë.

68. Të konsultohen përfaqësuesit romë dhe sinti gjatë përpilimit të politikave të arsimit që ndikojnë tek ata.

69. Të promovohen në mënyrë aktive mundësitë në fushën e arsimit për fëmijët e romëve dhe të sintive, sidomos duke u siguruar ndihmë lidhur me gjuhën dhe ndihma të tjera .

70. Të merren masa të veçanta për të ngritur cilësinë dhe efikasitetin e arsimit të fëmijëve romë dhe sinti. Të inkurajohet përfaqësimi më i madh i popullatës romë dhe sinti në mesin e mësimdhënësve në shkolla.

71. Të përfshihet historia dhe kultura romë në tekstet shkollore, duke i dhënë konsiderata të veçanta përvojës së popullatës romë dhe sinti gjatë Holokaustit.

72. Të shqyrtohen masat për të siguruar respektim, mbrojtje dhe avancim të gjuhës romë dhe mësimdhënies së saj, si dhe të kulturës romë si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore të romëve dhe sintive.

73. Të krijohen dhe zbatohen programe shkollore përfshirëse të desegregacionit që synojnë: (1) ndërprerjen e praktikës së orientimit sistematik të fëmijëve romë në shkolla dhe klasë të veçanta (p.sh., shkollat e personale me pengesa mentale, shkolla dhe klasë të destinuara vetëm për fëmijët romë dhe sinti); dhe (2) transferimin e fëmijëve të romëve nga shkollat speciale në shkolla të orientimit të përgjithshëm.

74. Të ndahen burime financiare për transferimin e fëmijëve romë në arsimin e orientimit të përgjithshëm dhe për krijimin e programeve mbështetëse të shkollave për ta lehtësuar kalimin në arsim të orientimit të përgjithshëm.

75. Të lehtësohet qasja e fëmijëve të romëve në rrjedhat e përgjithshme arsimore duke ndërmarrë masa siç janë:

- (a) Marrja e masave për çrrënjosjen e manifestimeve të paragjyqimeve ndaj popullatës rome dhe sinti në shkolla;
- (b) Trajnimi i edukatorëve sa i përket arsimit shumëkulturore dhe mënyrave se si të vepron me klasat e përziera etnikisht;
- (c) Zhvillimi i strategjive për të fituar përkrahje më të gjerë të komunitetit për disegregacionin e shkollave;
- (d) Sigurimi i mbështetjes për të shmangur dallimin midis fëmijëve romë dhe sinti dhe nxënësve të tjerë, përfshirë edhe përmes programeve parashkollore të destinuar për përgatitjen e fëmijëve romë dhe sinti për shkollën fillore;
- (e) Sigurimi i mbështetjes për shtimin e numrit të ndërmjetësve /trajnerëve dhe arsimtarëve prej brenda komuniteteve rome.

76. Të krijohen dhe zbatohen planprograme antiraciste për shkolla, si dhe fushata kundër racizmit për mediet.

77. Të zhvillohen politika që shqyrtojnë spektrin e plotë të faktorëve që kontribuojnë në vijueshmërinë e ulët të shkollës nga fëmijët romë dhe sinti. Kjo përfshin, mes tjerash, sigurimin që familjet rome dhe sinti kanë dokumentacion të nevojshëm për regjistrim sikurse çdo banor tjetër.

78. Të shqyrtohet elaborimi i programeve të mbështetjes sociale për familjet rome me të ardhura të ulëta me fëmijë të moshës shkollore.

79. Të nxitet vijueshmëria e rregullt në shkolla nga fëmijët romë dhe sinti, përveç tjerash, përmes përfshirjes së familjes dhe ndërmjetësve socialë, shtimit të vetëdijes të prindërit dhe të rriturit romë dhe sinti për përgjegjësinë e tyre për ta ndihmuar vijimin e fëmijëve në shkollë dhe, në veçanti, qasjen e barabartë të vajzave në shkollë.

80. T'i kushtohet vëmendje e veçantë sigurimit të vajzave rome dhe sinti me mundësi të barabarta për përfshirje në arsim dhe në shoqëri dhe të përpilohet programe për t'iu kundërvënë shkallës së tyre posaçërisht të lartë të largimit nga shkolla.

81. Të shqyrtohet përpilimi i programeve adekuate për ata që nuk e kanë përfunduar shkollimin fillor ose që janë analfabetë.

82. Të zhvillohen, kur të jetë e nevojshme, programe të bursave për studentët romë dhe të inkurajohen që të marrin pjesë më shumë në programe ekzistuese të bursave.

83. Të inkurajohet popullata romë dhe sinti për të mësuar përdorimin e kompjuterit duke krijuar faqe të internetit për informimin e tyre.

84. Të vlerësohet në mënyrë periodike efikasiteti i politikave të arsimit.

Veprimet e rekomanduara nga institucionet dhe strukturat e OSBE-së:

85. KLPK-ja do të inkurajojë shtetet pjesëmarrëse që t'u përmbahen zotimeve të tyre për të siguruar qasje të lirë dhe të barabartë në arsim publik për të gjithë anëtarët e shoqërisë, dhe t'i inkurajojnë ata të ndërmarrin hapa për përmirësimin e gjendjes së popullatës romë dhe sinti në këtë pikëpamje.

86. KLPK-ja do të vazhdojë të hartojë udhërrëfyes për modelet e arsimit, përmbajtjen e planprogrameve dhe të mësimin të gjuhës amtare dhe në gjuhën amtare, duke përfshirë edhe gjuhën romë.

VI. Rritja e pjesëmarrjes në jetën publike dhe politike

Populli romë dhe sinti përballen me sfida të posaçme në përpjekje për të marrë pjesë në jetën publike — veçanërisht në atë politike — të vendeve të tyre përkatëse. Nivelet e ulëta të arsimit dhe, në raste të caktuara, diskriminimi kundër tyre, i kontribuon në masë të konsiderueshme përfaqësimit jo të duhur të popullit romë dhe sinti në të gjitha nivelet e qeverisë. Populli romë dhe sinti ka të drejtë të barabartë të marrë pjesë në çështjet publike. Këtu përfshihet e drejta e votës, e kandidimit në zgjedhje, e pjesëmarrjes në çështjet publike dhe e formimit të partive politike pa diskriminim. Përpjekjet e bëra viteve të fundit për të përkrahur pjesëmarrjen e romëve në politikë duhet të inkurajohen, veçanërisht ato që zënë fill nga vetë grupet e romëve.

Veprimet e rekomanduara nga shtetet pjesëmarrëse:

87. Shtetet pjesëmarrëse duhet të jenë proaktive për të siguruar që populli romë dhe sinti, njësoj si banorët tjerë, t'i kenë të gjitha dokumentet e nevojshme, përfshirë certifikatat e lindjes, dokumentet e identifikimit dhe certifikatat e sigurimit shëndetësor. Në zgjidhjen e problemeve që lidhen me mungesën e dokumenteve bazë, shteteve pjesëmarrëse u këshillohet fuqishëm të punojnë në partneritet me organizatat civile të romëve dhe sintive.

88. Shtetet pjesëmarrëse inkurajohen t'i marrin parasysh kushtet themelore vijuese për të siguruar pjesëmarrje efektive nga populli romë dhe sinti në jetën publike dhe politike:

— *Inkuadrimi i hershëm:*

Çdo iniciativë që ka të bëjë me popullin romë dhe sinti duhet t'i inkuadrojë ata në periudhat më të hershme të fazave të zhvillimit, zbatimit dhe vlerësimit;

— *Përfshirja:*

Populli romë dhe sinti duhet të përfshihet në proceset formale konsultative, ndërkaq efektshmëria e mekanizmave të krijuar për pjesëmarrjen e tyre në formësimin e

iniciativave kryesore të politikave duhet të sigurohet duke i inkuadruar ata në procesin e gjerë të përfaqësimit;

— *Transparenca:*

Programet dhe propozimet duhet të qarkullojnë mjaft kohë para afateve përfundimtare të marrjes së vendimeve për të mundësuar analizë dhe kontribut kuptimplotë nga përfaqësuesit e komuniteteve romë dhe sinti;

— *Pjesëmarrja kuptimplote nga populli rom dhe sinti në të gjitha nivelet e qeverisë:*

Pjesëmarrja e popullit rom dhe sinti në qeverisjen lokale është qenësore për zbatimin efikas të politikave që i prekin ata;

— *Zotërimi:*

Populli rom dhe sinti luan rol qenësor dhe të pazëvendësueshëm për të siguruar që e drejta e pjesëmarrjes në procesin politik ndiqet në praktikë.

89. Zyrtarët e zgjedhur duhet të krijojnë marrëdhënie të ngushta pune me komunitetet romë dhe sinti.
90. Të krijohen mekanizma për të siguruar komunikim të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të hapur midis përfaqësuesve të romëve dhe sintive dhe të autoriteteve qeveritare, duke përfshirë organet këshillimore dhe konsultative.
91. Të lehtësohet ndërveprimi midis udhëheqësve politikë në nivelet lokale dhe nacionale dhe grupeve të ndryshme romë.
92. Të organizohen fushata vetëdijesimi për zgjedhjet, ashtu që të rrisin pjesëmarrjen e elektoratit rom në zgjedhje
93. Të sigurohet që votuesit romë të mund marrin vendime të lira dhe të informuara për votim në zgjedhje.
94. Të merren masa për të garantuar të drejta të barabarta votimi për gratë, duke përfshirë vënien në zbatim të ndalesave ndaj të ashtuquajturit “votim familjar”.
95. Të inkurajohet populli rom dhe sinti për përfshirje më aktive në shërbimin publik, duke përfshirë, kur është e nevojshme, përmes futjes në përdorim të masave të posaçme për të promovuar pjesëmarrjen e tyre në shërbimin civil.
96. Të inkurajohet përfaqësimi i popullit rom dhe sinti në postet e zgjedhura dhe të emëruara në të gjitha nivelet e qeverisjes.
97. Të fuqizohen dhe integrohen individët romë dhe sinti në proceset e vendimmarrjes së shteteve dhe lokaliteteve si përfaqësues të zgjedhur të komuniteteve të tyre dhe si qytetarë të vendeve të tyre përkatëse.

98. Të promovohet pjesëmarrja e grave romë në jetën publike dhe politike; gratë romë duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në mënyrë të barabartë me meshkujt në mekanizmat konsultativë dhe të tjerë, të dizajnuar për të shtuar qasjen në të gjitha fushat e jetës publike dhe politike.

Veprimet e rekomanduara nga institucionet dhe strukturat e OSBE-së:

99. ODIHR-i dhe, kur është e përshtatshme, institucionet dhe strukturat e tjera të OSBE-së, duke përfshirë operacionet e OSBE-së në terren, do të hartojnë programe që synojnë përkrahjen për regjistrimin e nevojshëm për pjesëmarrje të plotë politike.
100. ODIHR-i/PKÇRS-ja duhet të ndihmojë për organizimin e trajnimit për OJQ-të romë dhe prej tyre, duke përfshirë organizatat e mediae, për komunitetet më të gjëra të romëve mbi çështjet e proceseve dhe të pjesëmarrjes demokratike.
101. ODIHR-i dhe, kur është e përshtatshme, institucionet dhe strukturat e tjera të OSBE-së, duke përfshirë operacionet e OSBE-së në terren, do të hartojnë dhe zbatojnë programe të edukimit të votuesve dhe të regjistrimit të votuesve.
102. ODIHR-i do të veprojë si katalizator për këmbimet e informatave dhe praktikat më të mira midis shteteve pjesëmarrëse dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.
103. ODIHR-i do të vazhdojë dhe fuqizojë praktikën e shqyrtimit të inkuadrimin të popullit rom në proceset e votimit dhe të zgjedhjeve, dhe do të vazhdojë praktikën e përfshirjes së ekspertëve romë dhe sinti në misionet e veta të vëzhgimit të zgjedhjeve në hapësirën e OSBE-së.
104. KLPK-ja, në kuadër të mandatit të saj, do të vazhdojë t'i këshillojë shtetet mbi mënyrat dhe mjetet e përshtatshme të lehtësimit të pjesëmarrjes së popullit rom dhe sinti në të gjitha fushat e jetës publike.
105. ODIHR-i/PKÇRS-ja dhe, kur është e përshtatshme, institucionet dhe strukturat e tjera të OSBE-së, duke përfshirë operacionet e OSBE-së në terren, do të përpilojnë programe që inkurajojnë përfaqësuesit romë dhe sinti të paraqiten si kandidatë për organet e zgjedhura ose do të identifikojnë zgjidhje kreative që do të sigurojnë pjesëmarrjen e përfaqësuesve romë dhe sinti në proceset vendimmarrëse nacionale dhe lokale.
106. ODIHR-i do t'u kushtojë vëmendje të veçantë aktiviteteve që synojnë rritjen e qasjes së femrave romë në të gjitha fushat e jetës publike dhe politike.

VII. Romët dhe sintit në situatat e krizave dhe pas krizave

Shtetet pjesëmarrëse kanë obligim të sigurojnë që edhe në situatat e krizave edhe pas krizave, të gjitha të drejtat themelore, duke përfshirë të drejtat e refugjatëve që rrjedhin nga dokumentet relevante ndërkombëtare, veçanërisht nga Konventa e vitit 1951 përkitazi me statusin e refugjatëve dhe protokollin i saj i vitit 1967, janë të siguruara pa diskriminim. Ato marrin parasysh Parimet Udhëzuese mbi Zhvendosjet e Brendshme të KB-ve si kornizë të dobishme për punën e OSBE-së dhe përpjekjet në trajtimin e zhvendosjes brenda vendit.

Veprimet e rekomanduara nga shtetet pjesëmarrëse:

107. Të konsultohen popullatat rome dhe sinti kur bëhet përkufizimi i situatave të krizave, me qëllim që të lehtësohen procedurat adekuata dhe të identifikohen zonat e caktuara gjeografike nga të cilat vërshojnë refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit, si dhe të sigurojnë trajtimin e situatave specifike të popullit rom dhe sinti.
108. Të sigurohet që popullatat rome dhe sinti në situatat e zhvendosjes me dhunë (refugjatët dhe PZHbV-të) të regjistrohen si duhet dhe t'u sigurohen dokumentet përkatëse.
109. Shtetet pjesëmarrëse duhet të sigurojnë që të ketë programe për të promovuar zgjidhje të informuara përkitazi me vendimin e refugjatëve romë dhe sinti dhe PZHbV-ve përkitazi me zgjidhjet e qëndrueshme të gjendjes së tyre, duke përfshirë ushtrimin e të drejtës së tyre për kthim të sigurt, dinjitoz dhe të qëndrueshëm. Programet e tilla duhet t'u sigurojnë refugjatëve dhe PZHbV-ve informata konkrete përkitazi me secilën temë të brengave të tyre dhe duhet të vihen në dispozicion në gjuhët përkatëse.
110. Të sigurohet që refugjatët romë dhe sinti të trajtohen në përputhje me normat dhe standardet relevante ndërkombëtare të mbrojtjes, dhe pa diskriminim.
111. Të shfrytëzohet roli i ODIHR-it në parandalimin e konfliktit dhe në identifikimin e fushave të ndërhyrjes së hershme dhe të përdorin ekspertizat e KLPK-jes së OSBE-së në këtë aspekt.
112. T'i kushtohet vëmendje e posaçme nevojave të grave dhe fëmijëve romë dhe sinti në situatat e krizave dhe pas krizave, veçanërisht duke u siguruar atyre qasje në mbrojtjen shëndetësore, banim dhe shkollim.

Veprimet e rekomanduara nga institucionet dhe strukturat e OSBE-së:

113. ODIHR-i do të shfrytëzojë rolin e tij specifik në trajtimin për parandalimin e konfliktit dhe në identifikimin e fushave të krizave të mundshme që kërkojnë ndërhyrje të hershme.
114. Në përputhje me mandatin e vet, i bëhet thirrje ODIHR-it/PKÇRS-së që të përgjigjen me efektshmëri ndaj situatave të krizave, pos tjerash, në bashkëpunim me qeveritë përkatëse, organet ndërqeveritare dhe organizatat ndërkombëtare, e në veçanti UNHCR-i, për të siguruar mbrojtjen e komuniteteve të rrezikuara rome.
115. ODIHR-i/PKÇRS-ja do të ngrijnë vetëdijen në mesin e zyrtarëve publikë, gazetarëve dhe të tjerëve mbi gjendjen e popullit rom dhe sinti në kriza ose zonat e konfliktit.
116. ODIHR-i do të marrë përsipër një rol proaktiv në analizimin e masave të ndërmarra nga shtetet pjesëmarrëse përkitazi me popullin rom dhe sinti dhe do të ofrojë këshilla e veta me synimin e trajtimit më të mirë të këtyre elementeve të tensionit në kontekstet e caktuara lokale, të cilat mund të arrijnë, nëse nuk parandalohen, në situata të hapura konflikti.

117. KLPK-ja do të vazhdojë të ushtrojë mandatin e vet të parandalimit të konfliktit që në fazën më të hershme të mundshme.

VIII. Rritja e bashkëpunimit dhe e koordinimit me organizatat e tjera ndërkombëtare dhe OJQ-të

Duke u nisur nga vëmendja e shtuar që po u kushtohet çështjeve që kanë të bëjnë me popullin rom dhe sinti nga organizata të ndryshme ndërkombëtare, kërkohet koordinim dhe bashkëpunim për të shmangur përsëritjen e njëjtë të përpjekjeve. Me synim për sigurimin e zbatimit efikas të Planit të veprimit, OSBE-ja, dhe në veçanti ODIHR-i, do të bashkëpunojnë ngushtë me organizatat ndërkombëtare dhe organizatat joqeveritare.

118. ODIHR-i/PKÇRS-ja do të vazhdojë të marrë pjesë aktivisht në *Grupin Joformal të Kontaktit për Romët të Organizatave Ndërqeveritare*².
119. Për fuqizimin dhe ngritjen në shkallë më të lartë të këtij grupi joformal do të arrihet pëlqimi dhe kjo do të zbatohet në bashkëpunim me të gjithë partnerët relevantë, veçanërisht duke siguruar përfshirjen e përfaqësuesve të shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së. Mbledhjet e rregullta të Grupit Joformal të Kontaktit në nivel ekspertësh, ose në nivel më të lartë sa herë që vlerësohet e domosdoshme, do të merren në konsideratë me synimin për ta çuar më tutje këtë qëllim.
120. Grupi Joformal i Kontaktit duhet të përcaktojë orientimet dhe prioritetet e përbashkëta, si dhe koordinimin dhe bashkëpunimin më të mirë me qëllim të shmangies së përsëritjes së njëjtë të përpjekjeve.
121. ODIHR-i/PKÇRS-ja do të kërkojë të konsolidohet “Grupi Ndërkombëtar i Kontaktit për Romët”³ dhe do të kontribuojë më tej në iniciativën e Këshillit të Evropës për një forum të mundshëm evropian për romët dhe endacakët.
122. ODIHR-i/PKÇRS-ja do t’u sigurojë informata dhe shërbime të koordinimit institucioneve përkatëse nacionale dhe ndërkombëtare, dhe do të lehtësojnë dialogun midis tyre dhe me OJQ-të rome.
123. ODIHR-i/PKÇRS-ja do të kërkojë të krijojnë marrëdhënie me organizatat rome dhe sinti dhe do t’u ndihmojnë atyre t’i koordinojnë përpjekjet dhe resurset e tyre, si në kuadër të shteteve të veçanta, ashtu edhe përtej kufijve, ndërkaq vetë do të vihen në dispozicion të plotë të mundësive të ofruara nga politikat ekzistuese nacionale dhe ndërkombëtare që prekin popullin rom dhe sinti.
124. ODIHR-i/PKÇRS-ja do të përdorinë përvojën dhe kontributin e projekteve ekzistuese të monitorimit të zhvilluara nga organizatat e tjera ndërkombëtare.

² *Grupi Joformal i Kontaktit për Romët i Organizatave Ndërqeveritare* përbëhet nga përfaqësuesit e OSBE-së/ODIHR-it, Këshilli i Evropës, Komisioni Evropian dhe Bashkimi Evropian.

³ Grupi Ndërkombëtar i Kontaktit për Romët është themeluar në tetor të vitit 2000, me iniciativë të Pikës së kontaktit të ODIHR-it për çështjet e romëve dhe sintive. Në Grupin e Kontaktit hyjnë përfaqësues të Unionit Ndërkombëtar të Romëve, të Kongresit Nacional Rom, përfaqësuesit e zgjedhur romë, ekspertët romë dhe ODIHR-i/ PKÇRS-ja.

IX. Pika e kontaktit e ODIHR-it për çështjet e romëve dhe sintive

125. Kurështë e nevojshme, ODIHR-i/ PKÇRS-ja do të lehtësojnë këmbimin e përbashkët të informatave midis shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së që kanë hartuar ose që po kërkojnë të përmirësojnë politikat nacionale mbi popullin rom dhe sinti.
126. Nëse i kërkohet, ODIHR-i/ PKÇRS-ja do t'i këshillojnë shtetet pjesëmarrëse mbi politikat e ardhshme që kanë të bëjnë me popullin rom dhe sinti, ndërkaq do të stimulojnë debatet ndërmjet qeverive dhe OJQ-ve rome.
127. ODIHR-i/PKÇRS-ja do të përkrahin aftësimin e kuadrove për OJQ-të rome dhe sinti.
128. ODIHR-i/PKÇRS-ja do të krijojnë një bazë të të dhënave me praktikat më të mira në shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së.
129. ODIHR-i/PKÇRS-ja do të marrin përsipër një rol proaktiv për analizimin e masave të ndërmarra nga shtetet pjesëmarrëse, si dhe në situatat e caktuara dhe incidentet përkitazi me popullin rom dhe sinti. Kah fundi i kësaj PKÇRS-ja do të vendosë dhe zhvillojë kontakte të drejtpërdrejta me shtetet pjesëmarrëse dhe do t'u ofrojë atyre këshilla dhe mendime.
130. Qeveritë në fjalë do të bashkëpunojnë me ODIHR-in/PKÇRS-jen për identifikimin e zgjidhjeve efikase të situatave të krizave.
131. ODIHR-i/PKÇRS-ja do t'u sigurojnë komuniteteve rome dhe sinti më shumë informata mbi resurset dhe aktivitetet e OSBE-së.
132. Në bashkëpunim me institucionet dhe strukturat përkatëse të OSBE-së, ODIHR/i do të zhvillojë veprim të përshtatshëm që synon trajtimin e rrënjëve të shkaqeve të trafikimit të qenieve njerëzore, sidomos të fëmijëve, dhe rritjen e vetëdijesimit për pasojat e saj në mesin e komuniteteve rome dhe sinti.

X. Zbatimi: shqyrtimi dhe vlerësimi

133. Zbatimi i dispozitave të Planit të veprimit do të shqyrtohet në mbledhjet e zbatimit të dimensionit njerëzor, konferencat shqyrtuese dhe ngjarjet e tjera relevante të dimensionit njerëzor.
134. Duke u mbështetur në rezultatin e mbledhjeve të sipërpërmendura, si dhe në kontributin nga Grupi i konsoliduar Joformal i Kontaktit për Romët i organizatave ndërqeveritare dhe Grupit Ndërkombëtar të Kontaktit për Romët, Drejtori i ODIHR-it do t'i raportojë Këshillit të Përhershëm, i cili mund t'u rekomandojë shteteve pjesëmarrëse dhe institucioneve të OSBE-së prioritetet për bashkëpunim dhe koordinim.
135. Herë pas here, Këshilli i Përhershëm do të organizojë takime informative joformale me Pikën e kontaktit për çështjet e romëve dhe sintive në fushat e përfshira nga Plani i tanishëm i veprimit, me qëllim që të vlerësojë ndikimin në nivel nacional dhe lokal të masave të parapara prej tij.

136. Me synim të lehtësimit të procesit të shqyrtimit të zbatimit, shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së inkurajohen të sigurojnë informata mbi zhvillimet më të fundit në gjendjen e popullit rom dhe sinti dhe/ose masat e nxitura nga ky Plan i veprimit në mbledhjet e zbatimit të dimensionit njerëzor, para konferencave shqyrtuese dhe Këshillit të Përhershëm, kur është e përshtatshme.
137. Të gjitha institucionet dhe strukturat përkatëse të OSBE-së, duke përfshirë operacionet e OSBE-së në terren, do të vazhdojnë të ndërveprojnë ngushtë me shtetet pjesëmarrëse, me qëllim që t'u ndihmojnë atyre në zbatimin e Planit të veprimit.
138. ODIHR-i/PKÇRS-ja do t'u shpërndajnë informata mbi këtë Plan komuniteteve dhe organizatave rome dhe sinti dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.
139. Me qëllim që ODIHR-it/PKÇRS-së t'i mundësohet realizimi i këtyre detyrave që i janë besuar në Planin e tanishëm të veprimit, Këshilli i Përhershëm i OSBE-së do të trajtojë çështjen e sigurimit të resurseve njerëzore dhe financiare adekuate. Detajet do të funksionalizohen nga Komiteti Këshillimor mbi Menaxhmentin dhe Financat dhe do t'i paraqiten Këshillit të Përhershëm.